



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.72/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi – kryesues, Kymete Kicaj dhe Hajriz Hoti- anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Subjektit Politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Komuna Graçanicë, të paraashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ, lidhur me administrimit e procesit të numërimit të fletëvotimeve në Qendrën Komunale e Numërimit – QKN, në Komuna Novobërdë, dhe Qendrën Komunale e Numërimit –QKN në Komunën Leposaviq, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.01.2026, merr këtë :

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZP.Anr.72/2026 datë 10.01.2026, e paraashtruar nga Subjektit Politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Komuna Graçanicë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ, lidhur me administrimit e procesit të numërimit të fletëvotimeve në Qendrën Komunale e Numërimit –QKN, në Novobërdë dhe Qendrën Komunale e Numërimit –QKN, në Komuna Leposaviq, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 10.01.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.72/2026 nga Subjekti Politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Komuna Graçanicë, në të cilën pretendon se ka pasur parregullsi të rënda që u vunë re gjatë procesit të numërimit të votave në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 28.12.2025, të cilat tregojnë për mundësinë e shfaqjes së të ashtuquajturit "trenit bullgar" në komunat Leposaviq, dhe Novobërdë.

Bazuar në deklaratat e përfaqësuesve të QKN-së që ishin të pranishëm në atë ditë në qendrat e numërimit të votave, si dhe pas shqyrtimit të rezultateve të publikuara zyrtarisht nga Komisioni Qendror Zgjedhor, u vërejt një model votimi që devijon nga normat statistikore dhe demokratike të zakonshme. Domethënë, në një numër të madh të qendrave votimi është e dukshme favorizimi i spikatur i dhjetë kandidatëve të parë në listat zgjedhore, ndërsa kandidati i njëmbëdhjetë regjistron një rënie të menjëhershme dhe dramatike të numrit të votave të fituara, pa asnjë shpjegim objektiv dhe logjik. Ky model përsëritet në disa njësi zgjedhore, gjë që forcon më tej dyshimet se nuk kemi të bëjmë me një rastësi, por me një parregullsi sistematike në procesin zgjedhor.

Më tej në ankesë pretendohet se duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së integritetit të procesit zgjedhor dhe besimit të qytetarëve në institucionet demokratike, kërkojnë që Komisioni Qendror Zgjedhor të kryejë një kontroll të detajuar të materialit zgjedhor në komunat e përmendura, duke përfshirë ri-numërimin e votave në qendrat e dyshimta të votimit, si dhe të ndërmarrë të gjitha masat e parashikuara me ligj për të përcaktuar përgjegjësi eventuale.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur raportet e përfaqësuesve të QKN-së në komunën Novobërdë dhe Leposaviq dhe fotografi nga faqja e KQZ-së për shkeljet e përmendura në raporte.

Në përgjigje në ankesë KQZ ka sqaruar se, bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilitdo VV ose përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit vlejné procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.

KQZ, gjithashtu njofton se procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), Procedurën e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese, të cilat mbështeten në pritshmërinë e tij subjektive për të marrë një numër më të madh votash, theksojmë se pritshmëritë personale ose subjektive të kandidatëve nuk përbëjnë bazë ligjore për vlerësimin e rregullsisë së procesit zgjedhor dhe as për kontestimin e rezultateve zgjedhore, përderisa procesi i votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet nënligjore të lartcekura dhe përkatëse.

Më tej në përgjigje theksohet se sa i përket pretendimeve të palës, për dyshimet dhe parregullsitë në vendvotimet në ditën e zgjedhjeve të datës 28 dhjetor 2025, në komunën Leposaviq dhe Novobërdë, nuk qëndrojnë sepse, bazuar në Raportin e Dhomës Operative të KQZ, për ditën e zgjedhjeve, nuk është evidentuar ndonjë parregullsi në procesin e votimit apo numërimit, si dhe sa i përket fenomenit "treni bullgar".

Ankesa e ankuesit lidhur me procesin e votimit nuk është ankesë e paraqitur brenda afatit ligjor, në kuptim të nenit 119 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili përcakton se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas

këtij ligji ose rregullave ligjore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”

Sa i përket pretendimeve të palës lidhur me dyshimet dhe parregullsitë e supozuara në vendvotim në ditën e zgjedhjeve të mbajtura më 28 dhjetor paraqitur pas skadimit të afatit ligjor prej 48 orësh, te përcaktuar me dispozitën e lartcekur, andaj konsiderohet ankesë e paraqitur jashtë afatit ligjor, pra është e pas afatësime .

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi lidhur me parregullsitë në numërimin e votave dhe me as një provë konkrete nuk ka mundur të konstatoj pretendimet e tij. Pra, nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të dëshmonin pretendimet e saj.

Andaj, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Novobërdës (shih të bashkangjitur konfirmimin e ZEKKZ), aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 30.12.2025¹ si dhe konfirmimit për KKZ në Leposaviq më datën 30.12.2025 (shih të bashkangjitur konfirmimin e ZEKKZ), ndërsa pala ankesën e ka parashtruar ankesën me datën 10.01.2026. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit " Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”.

Paneli, pas shqyrtimit të paraprak të ankesës dhe, përgjigjes në ankesë, gjeti se :

-Ankesa është e pasafatshme.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 10.01.2026, lidhur me parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrat Komunale të Numërimit-QKN, në Komunitet Leposaviq, dhe Novobërdë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 Dhjetor 2025.

Në nenin 105 par. 1, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në mënyrë decisive thuhet se *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që *“ Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”,* ndërsa nën paragrafi 5.16. të të njëjtës rregullore parashihet që *“Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR”*.

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP me datë 10.01.2026 lidhur me parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrat Komunale të Numërimit-QKN, në Komunitet Leposaviq, dhe Novobërdë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 Dhjetor 2025, e po ashtu edhe nga

provat e bashkangjitura në përgjigjen e KQZ-së është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunitat Novobërdë, dhe Leposaviq janë përmbyllur me datën 30.12.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është parashtruar brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe e njëjta hedhet e palejuar pasafatshme.

Paneli pas analizimit të shkresave të lëndë ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 9 par. 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 10.12.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë gjatë numërimit të QKN, i cili ka përfunduar më datë 30.12.2025 në të dy Komunitat për të cilat Komuna është parashtruar ankesa, që bazuar në dispozitat ligjore të lartëpërmendura, ankesa e parashtruar është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.72/2025 datë 12.01.2026

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLË JURIDIKE : kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.